




Funded by  
the European Union



# Rezilienca ndaj dezinformatave gjatë periudhës zgjedhore në Kosovë

Çrregullimi i informacionit dhe FIMI në zgjedhjet në Kosovë në vitin 2025 (përfunduar shkurtin)





Funded by  
the European Union



# Rezilienca ndaj dezinformatave gjatë periudhës zgjedhore në Kosovë

Çrregullimi i informacionit dhe FIMI në zgjedhjet në Kosovë në vitin 2025 (përfshirë shkurtin)

**Publikues:** ADS/hibrid.info

## **DISCLAIMER:**

Ky publikim është prodhuar me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian. Për përmbajtjen e tij është përgjegjës vetëm Hibrid.info dhe ajo nuk pasqyron domosdoshmërisht qëndrimet e Bashkimit Evropian.

© Të gjitha të drejtat janë të rezervuara nga ADS/hibrid.info. Të drejtat e pronës intelektuale mbrohen me Ligjin Nr. 04/L-065 për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta dhe me Ligjin Nr. 05/L-047 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.04/L-065 për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta.

Asnjë pjesë e këtij botimi nuk mund të riprodhohet, të ruhet në sisteme elektronike apo të bartet, në çfarëdo forme apo me çfarëdo mjeti, qoftë mekanik, me fotokopje, incizim apo në mënyra të tjera, pa lejen paraprake me shkrim të botuesit Publikues: ADS/hibrid.info

# Contents

<b>01</b>	<b>Hyrje</b>	<b>5</b>
<hr/>		
<b>02</b>	<b>Metodologjia</b>	<b>6</b>
<hr/>		
<b>03</b>	<b>Monitorimi digjital i hapësirës informative</b>	<b>8</b>
<hr/>		
<b>04</b>	<b>Keqinformimi në shqip dhe serbisht në periudhën 9 tetor -31 dhjetor.</b>	<b>10</b>
<hr/>		
<b>05</b>	<b>Keqinformatat me përmbajtje ndër-etnike</b>	<b>22</b>
<hr/>		
<b>06</b>	<b>Ndikimi dhe manipulimi i informacionit nga jashtë (FIMI)</b>	<b>25</b>
<hr/>		
<b>07</b>	<b>Përfundim</b>	<b>32</b>
<hr/>		

# Hyrje

Ky raport mbulon periudhën nga 9 tetori deri më 31 dhjetor 2025 dhe përqendrohet në monitorimin e përmbajtjeve digjitale gjatë një kohe të ngarkuar politikisht, duke përfshirë zgjedhjet lokale dhe ato të parakohshme parlamentare në Kosovë. Gjatë kësaj periudhe, analiza jonë fokusohet në identifikimin dhe kategorizimin e keqinformimeve që qarkulluan në platformat online në gjuhë të ndryshme, duke përfshirë shqip, serbisht dhe anglisht. Raporti ofron një panoramë të rrjedhës së keqinformimeve sipas temave kryesore, duke përfshirë dezinformimin mbi proceset zgjedhore, sondazhet e fabrikuara, deklaratat e pavërteta të figurave publike, dhe përdorimin e videove të gjeneruara ose manipuluar me inteligjencë artificiale. Përveç kësaj, përmbajtjet me karakter ndëretnik janë identifikuar dhe analizuar, duke vlerësuar ndikimin e tyre në polarizimin shoqëror dhe tensionet lokale, veçanërisht në veri të vendit dhe në komunitetet me shumicë serbe.

Raporti gjithashtu shqyrton ndikimin e jashtëm të quajtur FIMI (Foreign Information Manipulation and Interference), duke identifikuar temat dhe narrativat që kanë pasur për qëllim manipulimin e perceptimeve të publikut dhe ndikimin mbi procesin zgjedhor. Analiza jonë e bazuar në monitorimin digjital ofron një vlerësim të strukturuar të përmbajtjeve problematike, duke i ndarë ato në kategori sipas natyrës së keqinformimit dhe ndikimit të mundshëm. Ky proces jo vetëm që evidenton llojet dhe intensitetin e keqinformimit gjatë periudhës së zgjedhjeve, por gjithashtu nënvizon modelet dhe mekanizmat që përdoren për të amplifikuar përmbajtje me karakter ndëretnik dhe për të lehtësuar ndërhyrjet e jashtme, duke ofruar një bazë për rekomandime dhe masa parandaluese në fushën e informimit publik dhe sigurisë digjitale.

# Metodologjia

Ky raport mbështetet në një proces të strukturuar dhe sistematik të monitorimit dhe analizës së përmbajtjeve mediatike gjatë periudhës 9 tetor – 31 dhjetor 2025 në Kosovë, e cila përfshin zgjedhjet lokale dhe ato parlamentare të parakohshme. Qëllimi kryesor i këtij hulumtimi është identifikimi, kategorizimi dhe interpretimi i përmbajtjeve që përmbajnë elemente të keqinformimit, manipulimit narrativ dhe dezinformimit të organizuar, si dhe matja e ndikimit të tyre në perceptimin publik dhe në procesin zgjedhor.

Monitorimi digjital i përmbajtjeve të kësaj periudhe është realizuar dhe përmbledhur duke përdorur platformën Pikasa.ai, e cila mundëson mbledhjen, kategorizimin dhe analizimin e të dhënave nga burime të ndryshme digjitale. Burimet e monitoruara janë ndarë në tri kategori kryesore:

1. Mediat sociale – përfshirë Facebook, TikTok dhe Telegram, ku janë analizuar faqe publike, grupe dhe profile individuale që kanë shpërndarë përmbajtje politike;
2. Mediat vendore online – portale informative dhe faqe që publikojnë lajme me ndikim të drejtpërdrejtë në opinionin publik;

3. Mediat dhe zyrtarët serbë si dhe ata rusë – kryesisht platformat mediatike serbe dhe ruse, si RT Balkan dhe Sputnik Serbia, si dhe deklaratat e zyrtarëve serbë, me fokus në identifikimin e narrativave të jashtme (FIMI) që ndikojnë në diskursin politik në Kosovë.

Gjatë këtij procesi monitorimi të 7,000 publikimeve, të bazuar në 100 artikuj të monitoruar çdo ditë, janë analizuar gjithsej 103 përmbajtje, përfshirë lajme nga media dhe përmbajtje të publikuara nga faqe, llogari dhe kanale në media sociale, që lidhen me temat zgjedhore, çështjet ndëretnike dhe manipulimin dhe ndërhyrjen e huaj të informacionit (FIMI). Këto materiale përfshijnë verifikime faktesh, analiza dhe vlerësime të narrativave dominuese. Nga këto, 85 përmbajtje janë materiale të verifikimit të fakteve (të shpërndara nga disa burime) – 70 në gjuhën shqipe dhe 15 në gjuhën serbe – ndërsa 18 përmbajtjet e mbetura përbëhen nga analiza dhe vlerësime narrative, përfshirë 8 në shqip, 7 në serbisht, 1 në rusisht dhe 2 në anglisht. Për më tepër, janë monitoruar edhe 115 përmbajtje në gjuhën serbe nga media ruse, të cilat përfshijnë analiza, vlerësime narrative dhe narrativa të lidhura me zgjedhjet,

duke reflektuar manipulimin dhe ndërhyrjen e huaj të informacionit (FIMI).

Përmbajtjet e trajtuara në fact-checking janë përzgjedhur mbi bazën e rëndësisë tematike dhe përfaqësojnë materiale që janë publikuar dhe amplifikuar gjerësisht nga dhjetëra llogari dhe faqe në media sociale. Për shembull, e njëjta dezinformatë është shpërndarë ose ripostuar mbi 100 herë në burime të ndryshme. Për më tepër, disa nga këto narrativa janë shfaqur edhe në media tradicionale, duke mundësuar përhapjen e mëtejshme të keqinformimit. Shkalla e lartë e amplifikimit tregon se këto përmbajtje kanë arritur te audienca e synuar, pasi përdoruesit janë ekspozuar në mënyrë të përsëritur ndaj tyre. Për këtë arsye, numri total pasqyron përmbajtjet tematike dhe jo publikime individuale nga një burim i vetëm, duke kapur temat dhe narrativat kyçe që janë


shpërndarë dhe amplifikuar më së shumti në hapësirën informative.

Analiza është realizuar duke kombinuar qasjen sasiore dhe cilësore. Në aspektin sasior, janë monitoruar çdo ditë rreth 100 burime publikuese, duke identifikuar përmbajtjet që përmbajnë informacione të pasakta, manipuluar ose të fabrikuara, me viralitet mbi 50 ndërveprime si kriter për përhapjen e tyre. Analiza cilësore ka vlerësuar mënyrën se si narrativat janë ndërtuar, përforcuar dhe shpërndarë në kontekste të ndryshme, përfshirë temat me origjinë ose ndikim të jashtëm. Kjo qasje e kombinuar ka mundësuar matjen e shpërndarjes sipas platformave, frekuencës dhe llojit të keqinformimit, duke ofruar një pasqyrë të detajuar mbi mekanizmat e prodhimit, amplifikimit dhe përhapjes së dezinformimit gjatë procesit zgjedhor.

# Monitorimi digjital i hapësirës informative

Sipas platformës së monitorimit “Pikasa.ai” dhe analizës mediatike të bazuar në inteligjencë artificiale, gjatë periudhës së raportimit janë publikuar gjithsej 158,123 artikuj në hapësirën mediatike të Kosovës, të fokusuar te 100 politikanët më të përmendur. Ndër ta, kryeministri në detyrë Albin Kurti ka marrë vëmendjen më të madhe mediatike, i ndjekur nga presidentja Vjosa Osmani dhe kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës, Bedri Hamza.


Në platformat sociale, janë regjistruar 30,328 postime, të cilat kanë gjeneruar gjithsej 23,401,221 ndërveprime, duke reflektuar një nivel të qëndrueshëm angazhimi të publikut me përmbajtjet politike.



Të ndara sipas gjuhës:

- Mediat në gjuhën shqipe: 152,960 artikuj dhe 30,642 postime në rrjete sociale, me gjithsej 23,652,297 ndërveprime.
- Mediat në gjuhën serbe: 6,304 artikuj dhe 683 postime në rrjete sociale, që kanë gjeneruar 123,550 ndërveprime.

Në ekosistemin mediatik në gjuhën serbe, Albin Kurti, Vjosa Osmani dhe Nenad Rašić rezultojnë figurat politike më të përmendura.



Për temën specifike “Zgjedhjet”, janë publikuar gjithsej 44,381 artikuj në të gjitha gjuhët, të cilët kanë arritur 742,162 ndërveprime (mesatarisht 16.72 ndërveprime për artikull). Në rrjetet sociale janë regjistruar 3,508 postime, me gjithsej 998,396 ndërveprime (mesatarisht 285 ndërveprime për postim).

- Përmbajtja në gjuhën shqipe: 41,779 artikuj (710,218 ndërveprime; mesatarisht 17.00 për artikull) dhe 3,189 postime në rrjete sociale (988,094 ndërveprime; mesatarisht 310 për postim).
- Përmbajtja në gjuhën serbe: 2,602 artikuj (31,944 ndërveprime; mesatarisht 12.28 për artikull) dhe 319 postime (10,302 ndërveprime; mesatarisht 32.29 për postim).


Kjo tregon qartë se vëllimi i madh i përmbajtjeve të lidhura me zgjedhjet ka krijuar mundësi të shumta për përhapjen dhe amplifikimin e keqinformimit në të gjitha platformat, duke rritur ndikimin e tij të mundshëm në perceptimin publik dhe në debatet elektorale.

# Keqinformimi në shqip dhe serbisht në periudhën 9 tetor -31 dhjetor

## Keqinformimi në shqip

Ndër 85 përmbajtjet e keqinformimit të verifikuara (të shpërndara në disa burime), 70 u identifikuan si keqinformata të publikuara në gjuhën shqipe. Analiza tregon një dominim të qartë të lajmeve të rreme, të cilat përbëjnë kategorinë më të shpeshtë me gjithsej 28 tema, duke reflektuar përpjekje të drejtpërdrejta për të fabrikuar ose deformuar realitetin informativ. Pas tyre, janë evidentuar 10 tema mashtrimi, të ndjekura nga clickbait me 6 tema, ku titujt sensacionalë janë përdorur për të tërhequr vëmendjen pa mbështetje faktike. Manipulimi i fakteve është identifikuar në 5 tema, ndërsa gabimet faktike dhe dezinformatat janë

regjistruar nga 4 tema secila, duke treguar një përzjerje mes pasaktësive të qëllimshme dhe atyre të pavullnetshme. Kategori të tjera përfshijnë përmbajtje të paverifikuara (3 tema), teori konspirative (2 tema), si dhe forma të kombinuara të keqinformimit, si clickbait i ndërlidhur me dezinformim (2 tema) dhe clickbait i shoqëruar me manipulim faktesh (1 rast). Po ashtu, janë identifikuar tema të izoluar të raportimit të njëanshëm, deklaratave gjysmë të vërteta, si dhe kombinime të tjera të keqinformimit, përfshirë lajme të rreme të shoqëruara me mashtrim dhe manipulim faktesh të ndërthurur me dezinformatë, secila me nga 1 rast.




Gjatë periudhës së monitorimit 9 tetor – 31 dhjetor 2025, keqinformimi i publikuar në media sociale dhe media tradicionale në gjuhën shqipe, është përqendruar kryesisht rreth temave me ndjeshmëri të lartë politike dhe institucionale, me fokus të veçantë në proceset zgjedhore. Zgjedhjet parlamentare përbëjnë temën më të shpeshtë të keqinformimit me gjithsej 26 tema, të ndjekura nga zgjedhjet lokale me 19 tema, duke reflektuar përpjekje të vazhdueshme për të delegjitimuar procesin zgjedhor, për të krijuar konfuzion rreth rezultateve dhe për të ndikuar në perceptimin publik gjatë fushatave. Tema të tjera të rëndësishme përfshijnë formimin e qeverisë (6 tema) dhe zhvillimet në veriun e Kosovës (3 tema), të cilat janë shoqëruar me narrativa polarizuese dhe interpretime të njëanshme.

Përveç këtyre temave dominante, janë identifikuar edhe një sërë temash të tjera me frekuencë më të ulët, por me potencial të lartë ndikimi, secila me nga 1 rast keqinformimi. Këto përfshijnë pretendime që lidhen me Qeverinë Kurti, shpenzimet qeveritare, djegien e shtëpisë së të moshuarve, vizitën e kryeministrit Kurti në selinë e NATO-s, punësimin në Gjermani, si dhe pretendime që derivojnë nga narrativa që ndërlidhin Kurtin, Rugovën dhe SHBA-të. Po ashtu, janë identifikuar keqinformime mbi rritjen ekonomike të Kosovës, masat e Bashkimit Evropian ndaj Kosovës, takime të zyrtarëve lokalë, ndarjen e Kosovës, koalicionet politike, përfshirë pretendimet për një koalicion mes Vetëvendosjes dhe Listës Serbe, si dhe çështje që lidhen me njohjen e shtetit të Kosovës, pagën


minimale, armatimin e FSK-së dhe paralajmërime të supozuara nga Moska për Kosovën. Gjithashtu, janë evidentuar tema të keqinformimit edhe jashtë kontekstit të drejtpërdrejtë vendor, si zgjedhjet lokale në Maqedoninë e Veriut, duke treguar se keqinformimi gjatë kësaj periudhe ka shfrytëzuar një gamë të gjerë temash për të ndikuar në diskursin publik dhe për të krijuar pasiguri politike dhe shoqërore.

Në tërësi, përmbajtjet keqinformuese të identifikuara gjatë periudhës së monitorimit shfaqen si narrativa me orientim të dyfishtë ndaj Qeverisë: një pjesë e tyre synonte ta mbështesë qeverinë përmes ekzagjerimit të arritjeve, ndërtimit të legjitimitetit ndërkombëtar dhe paraqitjes pozitive të çështjeve si rritja ekonomike, njohjet ndërkombëtare, vizitat zyrtare dhe armatosja e FSK-së; ndërsa pjesa tjetër ka karakter kritik, duke e paraqitur qeverinë si përgjegjëse për dështime, kriza ose vendime të kontestuara, përmes pretendimeve mbi shpenzimet qeveritare, masat e BE-së, koalicionet politike, pagën minimale, ndarjen e Kosovës dhe skenarë të supozuar të sigurisë.



Sa i përket publikuesve<sup>[1]</sup> të përmbajtjeve keqinformuese në gjuhën shqipe, analiza tregon se një pjesë e konsiderueshme e tyre janë shpërndarë përmes mediave sociale, të cilat përbëjnë kategorinë më dominuese me 49 tema, duke konfirmuar rolin qendror të këtyre platformave në amplifikimin e keqinformimit gjatë periudhës së monitorimit. Mediat online renditen të dytat me 16 tema, duke reflektuar se edhe portale informative, përmes raportimit të pasaktë, të njëanshëm ose sensacional, kanë kontribuar në qarkullimin e përmbajtjeve problematike.

Një kategori e veçantë përbëhet nga mediat e dyshimta, me gjithsej 5 tema, të cilat karakterizohen nga mungesa e transparencës editoriale, burime të paidentifikueshme dhe prije për publikimin e përmbajtjeve manipuluese ose të fabrikuar. Në total, 70 përmbajtje në gjuhën shqipe janë analizuar në kuadër të këtij raporti, duke treguar se keqinformimi nuk është i kufizuar vetëm në aktorë individualë apo platforma sociale, por shfaqet si një fenomen i shpërndarë ndërmjet mediave tradicionale online dhe ekosistemit digjital më të gjerë.




[1] Media (portale informative) dhe media sociale (faqe, llogari, kanale).

## Keqinformimi në serbisht\*

Në përmbledhje të keqinformimit në gjuhën serbe, analiza tregon se teoritë konspirative përbëjnë kategorinë më dominuese me 11 tema nga 15 në total, duke reflektuar përpjekje për të ndërtuar narrativa spekulative dhe të pabazuara që synojnë të nxisin mosbesim ndaj institucioneve dhe procesit zgjedhor. Krahas tyre, janë

identifikuar 2 tema dezinformate të drejtpërdrejta, si dhe 2 tema të përmbajtjeve të kombinuara, ku përmbajtja e paverifikuar është ndërthurur me dezinformim, duke e bërë edhe më të vështirë dallimin mes informacionit të saktë dhe atij të manipuluar.




Sa i përket temave për të cilat është identifikuar keqinformim, analiza tregon një përqendrim kryesisht në çështje me ndjeshmëri të lartë politike, ndëretnike dhe të sigurisë. Komuniteti serb, veriu i Kosovës dhe zgjedhjet lokale janë temat më të shpeshta, me nga 2 tema secila, duke reflektuar prirjen për të ndërtuar narrativa që synojnë polarizimin etnik dhe minimin e besimit në proceset demokratike.

Përveç këtyre, janë identifikuar tema të izoluara keqinformimi, secila me nga 1 rast, që lidhen me raportet Kosovë–Serbi, duke përfshirë konfliktin mes Kosovës dhe Serbisë, kufirin Kosovë–


Serbi, si dhe me tema historike dhe të drejtësisë tranzicionale, përfshirë “Shtëpinë e Verdhë”, rastin “Panda” dhe procesin e gjykimit të ish-krerëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK). Po ashtu, keqinformimi ka përfshirë edhe tema të tjera si zgjedhjet parlamentare, armatimin e Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK) dhe protestat në Tiranë, duke treguar se narrativat keqinformuese shtrihen përtej kontekstit strikt zgjedhor dhe shfrytëzojnë një gamë të gjerë temash për të ndikuar në opinionin publik, si dhe për të nxitur pasiguri politike dhe shoqërore.

\*Përmbajtja në gjuhën serbe përcaktohen ato që shpërndahen kryesisht përmes mediave të bazuara në Serbi dhe kanaleve të Telegramit.



Sa i përket kanaleve të publikimit, analiza tregon se shumica e përmbajtjeve keqinformuese janë publikuar në media, me gjithsej 10 tema, duke dëshmuar se portale informative dhe faqe mediatike kanë pasur një rol më të theksuar në qarkullimin e këtyre narrativave. Ndërkohë, mediat sociale përbëjnë 5 tema, duke reflektuar një prani më të kufizuar numerikisht, por

me potencial të konsiderueshëm amplifikimi për shkak të natyrës virale të këtyre platformave. Kjo shpërndarje tregon se, në këtë segment të veçantë të keqinformimit, mediat kanë qenë burimi kryesor i prodhimit të përmbajtjeve problematike, ndërsa mediat sociale kanë shërbyer kryesisht si kanale të rishpërndarjes dhe përforcimit të tyre.




# Zgjedhjet parlamentare të 28 dhjetorit

Sa i përket keqinformimeve që lidhen drejtpërdrejt me zgjedhjet parlamentare të 28 dhjetorit, analiza tregon se janë identifikuar gjithsej 26 përmbajtje keqinformuese nga 85, të cilat janë publikuar kryesisht në media sociale, me 23 tema, ndërsa mediat online përbëjnë 3 tema. Kjo shpërndarje tregon se platformat sociale kanë qenë kanali kryesor i qarkullimit dhe amplifikimit të keqinformimit gjatë zgjedhjeve parlamentare, duke mundësuar përhapje të shpejtë dhe arritje të gjerë të audiencës në një periudhë të ndjeshme politike.


Në aspektin e kategorive keqinformuese, lajmet e rreme dominojnë me 12 tema, duke reflektuar përpjekje të drejtpërdrejta për të fabrikuar informacione mbi procesin zgjedhor dhe rezultatet e tij. Pas tyre,

janë evidentuar 6 tema mashtrimi, ndërsa clickbait dhe manipulimi i fakteve janë identifikuar me nga 2 tema secila, duke treguar përdorimin e titujve sensacionalë dhe deformimin selektiv të informacionit për të ndikuar në perceptimin e votuesve. Kategori të tjera, më të izoluar, përfshijnë teori konspirative, përmbajtje të paverifikuara të kombinuara me manipulim fakesh, lajme të rreme të ndërthurura me mashtrim, si dhe përmbajtje tërësisht të paverifikuara, secila me nga 1 rast. Kjo strukturë kategorike dëshmon se keqinformimi gjatë zgjedhjeve parlamentare ka shfrytëzuar një kombinim të formave të drejtpërdrejta dhe të kamufluara të manipulimit informativ, me qëllim ndikimin në opinionin publik dhe në besimin ndaj procesit zgjedhor.

## Media sociale



## Media



Keqinformimet e identifikuar gjatë kësaj periudhe përqendrohen kryesisht në manipulimin e procesit zgjedhor dhe të perceptimit publik, përmes disa temave të përsëritura dhe të ndërlydhura. Një pjesë e konsiderueshme lidhet me sondazhe dhe exit poll-e të rreme, të publikuara para dhe gjatë ditës së zgjedhjeve, përfshirë sondazhe për nivelin kombëtar, diasporën dhe parti të veçanta politike, si dhe riciklimin e sondazheve të vjetra si aktuale. Paralelisht, janë shpërndarë pretendime të pabazuara për manipulim zgjedhor, përfshirë akuza për blerje votash me para nga Serbia, ndalime të supozuara të mjeteve me para nga Beogradi, si dhe narrativa për ndërhyrje të jashtme. Një temë tjetër e shpeshtë ka qenë keqinterpretimi ose fabrikimi i deklaratave të figurave publike dhe ndërkombëtare, përfshirë pretendime të rreme që u atribuohen Donald Trumpit, presidentit kroat, analistëve amerikanë apo politikanëve vendorë. Po



ashtu, janë identifikuar përmbajtje të manipuluar vizualisht dhe materiale të gjeneruara me inteligjencë artificiale, si imazhe dhe video që paraqesin rrejshëm figura politike kosovare me politikanë serbë, hapjen e Urës së Ibrit, grafite të paqena, apo që pretendojnë të shfaqin qëndrime elektorale të mërgimtarëve. Keqinformimi ka përfshirë edhe pretendime të rreme për koalicione politike, veçanërisht mes LVV-së dhe Listës Serbe, si dhe artikuj me tituj çorientues ose të njëanshëm që deformatojnë deklaratat apo rikthejnë tema të vjetra në kontekst zgjedhor. Në tërësi, këto tema tregojnë një strategji të shumëfishtë keqinformuese që kombinon sondazhe të fabrikuara, manipulim deklaratash, përmbajtje të rreme vizuale dhe narrativa konspirative, me synim ndikimin në besimin publik ndaj zgjedhjeve parlamentare të 28 dhjetorit dhe aktorëve kryesorë politikë.

## **Sondazhet e rreme**

Sondazhet e rreme për zgjedhjet parlamentare të 28 dhjetorit u shpërndanë gjerësisht në media sociale, duke arritur shikueshmëri milionëshe, veçanërisht në TikTok, përmes mbi 50 publikimeve që pretendonin të paraqisnin matje të opinionit publik. Që nga fillimi i nëntorit, hibrid.info ka identifikuar një sërë përmbajtjesh të tilla, të cilat në shumicën e temave mungonin metodologji të qarta dhe burime të besueshme, ndërsa disa

përmendnin kompani apo organizata joekzistuese si realizuese të “sondazheve”. Janë evidentuar gjithashtu manipulime përmes riciklimit të matjeve të vjetra dhe paraqitjes së tyre si aktuale, si dhe publikime gjatë vetë ditës së zgjedhjeve. Shumica e këtyre përmbajtjeve u vlerësuan si lajme të rreme, nuk mbështeteshin nga burime kredibile as përmes kërkimeve online, ndërsa një pjesë e tyre janë fshirë më pas nga platformat sociale.<sup>[2]</sup>

[2] [Sondazhet e rreme për zgjedhjet e 28 dhjetorit – shikueshmëri milionëshe | hibrid.info](#)



👍 986

💬 559

➦ 35

👍 782

💬 402

➦ 42

**K** Kosova Report  
December 13 at 7:25 PM · 🌐

LDK rënditet e para në këto zgjedhje sipas një sondazhi të cilin thuhet se e kanë bërë vet ata!

**LDK publikon sondazhet online:**

LDK: 54.3%  
PDK: 23.2%  
LVV: 17.2%

👍🌐 2K 1.2K comments 28 shares

👍 2K

💬 1.2K

➦ 28

## **Përmbajtje keqinformuese me inteligjencë artificiale**

Me afrimin e zgjedhjeve të parakohshme parlamentare më 28 dhjetor 2025, u vërejt një rritje shqetësuese e përdorimit të videove dhe imazheve të gjeneruara me inteligjencë artificiale për të shpërndarë narrative politike të manipuluar. Këto përmbajtje përfshinin qytetarë mërgimtarë në lokacione të ndryshme, si Aeroporti i Prishtinës, duke pretenduar se ata do të votonin për kandidatë të caktuar dhe duke krijuar përshtypjen e një mbështetjeje masive nga diaspora. Disa materiale përmbanin edhe pretendime të pabazuara për takime politike pas seancave parlamentare ose për mbështetje të fshehtë të kandidatëve. Analizat e platformave për verifikim treguan se videot dhe imazhet përmbajnë deformime tipike të deepfake, përfshirë mimikë jo të natyrshme, zë robotik dhe koherencë vizuale të dobët, duke dëshmuar qartë manipulimin artificial të përmbajtjes. Ndërveprimi i madh i audiencës me këto përmbajtje tregon se një pjesë e përdoruesve i merr ato si të vërteta, duke amplifikuar ndikimin e tyre dhe duke thelluar polarizimin politik.<sup>[3]</sup>

Në TikTok, u publikuan dhjetëra video të gjeneruara nga AI në stil kronikash televizive, duke marrë qindra mijëra shikime dhe favorizuar Lëvizjen Vetëvendosje. Përmbajtjet lidhnin diasporën me mobilizim për VV-në, përdornin sondazhe të rreme për mbështetje dhe paraqisnin rezultate fiktive të koalicioneve ose votave në rritje. Pavarësisht se videot ishin të etiketuar si “AI-Generated” dhe përmbanin logon e aplikacionit Sora, shumë shikues i morën për të vërteta. Ky fenomen tregon qartë rrezikun që përmbajtjet e gjeneruara me AI paraqesin për proceset demokratike dhe nevojën për vetëdijesim të publikut, verifikim të rreptë nga grupet e fact-checking dhe përgjegjësi më të madhe të platformave sociale. Gjithashtu, përdorimi i AI në gazetari duhet të mbikëqyret nga stafi editorial dhe çdo përmbajtje e gjeneruar artificialisht të etiketohet qartë për të ruajtur integritetin dhe besueshmërinë e informacionit.<sup>[4]</sup>

[3] [Videot politike të gjeneruara me inteligjencë artificiale në prag të zgjedhjeve në Kosovë](#)

[4] [Në TikTok qarkullojnë video të gjeneruara nga inteligjenca artificiale si “kronika televizive”.](#)



👍 3.7K

💬 486

➦ 267



👍 6.9K

💬 1.6K

➦ 347



👍 121

💬 91

➦ 18



👍 466

💬 292

➦ 61



👍 128

💬 71

➦ 18

## Rikthimi i përmbajtjeve të rreme dhe deklaratave të sajara në kohë zgjedhesh

Para zgjedhjeve të parakohshme parlamentare më 28 dhjetor, në mediat sociale janë rikthyer deklarata dhe qëndrime të mëhershme të zyrtarëve politikë, që përdoruesit i rishpërndajnë për të kujtuar premtime ose pozicione të kaluara. Krahas tyre, janë rikthyer edhe përmbajtje të rreme ose mashtruese që kishin qarkulluar më parë, si pretendime të rreme për presidentin serb Vuçiq lidhur me lidhjet e Listës Serbe me opozitën, deklarata të fabrikuara për kryeministrin Kurti dhe postime të sajara që lidhen me presidentin kroat Millanović. Edhe materiale vizuale të vjetra, përfshirë video të politikanëve dhe analistëve, janë publikuar përsëri për të krijuar përshtypje të rreme në kontekstin e zgjedhjeve. Ky fenomen tregon qarkullimin e informacionit të vjetruar ose manipulues me qëllim krijimin e perceptimeve të gabuara tek publiku.<sup>[5]</sup>



Gjatë periudhës para zgjedhjeve, shumë përmbajtje në rrjetet sociale i atribuojnë figurave publike deklarata të pabazuara, shpesh të sajara, për të ndikuar në opinionin publik. Këto përmbajtje kanë përfshirë figura si kryeministri Kurti, Rifat Jashari, Vuçiq, Millanović dhe ish-analistë të CIA-s, duke u shpërndarë kryesisht në Facebook dhe TikTok. Kontrolli i pretendimeve tregoi mungesë burimesh kredibile që të vërtetojnë deklaratat e cituara, ndërsa postimet shpesh u shpërndanë me komente dhe pëlqime, duke rritur rrezikun që audienca t'i perceptojë si të vërteta. Kjo tregon një model të përsëritur të qarkullimit të lajmeve të rreme dhe pretendimeve të paverifikuara për qëllime politike dhe manipulim publik.<sup>[6]</sup>



[5] Rikthimi i keqinformatave të vjetra në kohë zgjedhesh | [hibrid.info](http://hibrid.info)

[6] Deklarata të sajara që u atribuohen figurave të ndryshme publike lidhur me politikanë në Kosovë | [hibrid.info](http://hibrid.info)

## Zgjedhjet lokale

Gjatë zgjedhjeve lokale në Kosovë, një rrjet i lidhur me ndikime ruse përhapte një sërë keqinformatash dhe teori konspirative me qëllim të ndikimit në perceptimin publik. Këto përmbajtje përfshinin pretendime të rreme për hapjen e hetimeve urgjente për keqpërdorime në procesin e votimit në Fushë Kosovë dhe Obiliq, matje të falsifikuara të sondazheve dhe Exit Poll-ëve për komunat Prizren, Suharekë, Obiliq, Lipjan, Kaçanik, si dhe për Prishtinën dhe Prizrenin, si dhe pretendime të pabazuara për blerje votash në Mitrovicë dhe rikthim të flamujve serbë pas fitores së Listës Serbe në pjesën veriore. Shpërndarja e këtyre informacioneve bëhej kryesisht përmes TikTok, Facebook dhe Instagram, ku përdoroheshin grafikë, imazhe dhe video të manipuluar, shpesh në një format që dukej si sondazh apo raport zyrtar, por që nuk kishte asnjë burim të besueshëm.

Përveç këtij shpërndarjeje të informacionit të rremë, materiale të vjetra dhe deklarata të sajuara të politikanëve dhe analistëve u rikthyen në kontekst zgjedhor për të krijuar përshtypje të mbështetjes apo pakënaqësisë së qytetarëve ndaj kandidatëve dhe partive politike. Shpërndarja e këtyre përmbajtjeve, edhe pse të pakonfirmuara dhe të bazuara në materiale të vjetra, arriti të gjenerojë angazhim të konsiderueshëm nga përdoruesit, duke rritur rrezikun që audienca t'i perceptojë si informacione të sakta dhe duke ndikuar në mënyrë të drejtpërdrejtë në perceptimet politike gjatë zgjedhjeve lokale.

# Keqinformatat me përmbajtje ndër-etnike

Gjatë periudhës tetor–dhjetor 2025, në Shqipëri dhe Serbi u përhapën një sërë keqinformatesh dhe video-materialesh të manipuluar lidhur me raportet ndër-etnike dhe situatën politike në Kosovë. Këto përmbajtje, shpesh të publikuara në rrjete sociale si Facebook, TikTok dhe Telegram, përfshinin pretendime të rreme për ngjarje të rënda, koalicione politike, hyrje të FSK-së në veri dhe çështje territoriale, duke synuar të krijojnë perceptime të gabuara dhe tension ndër-etnik te audienca.

## ***Keqinformimi në shqip***

Gjatë periudhës së monitoruar, janë përhapur një sërë keqinformatesh dhe video-materialesh të manipuluar që lidhen me raportet ndër-etnike në Kosovë. Një shembull i qartë është videoja e publikuar më 21 tetor 2025 në Facebook ku shfaqej një vajzë serbe duke bërë thirrje që Serbia ta njohë Kosovën; ky material ishte i krijuar me inteligjencë artificiale dhe nuk pasqyronte një ngjarje reale.<sup>[7]</sup> Në të njëjtën linjë, më 17 tetor 2025, disa media dhe portale në Shqipëri, përdorën gabimisht termin “komunat serbe” për të referuar komunat në veri të Kosovës gjatë raportimeve për hyrjen e FSK-së, duke krijuar keqkuptime mbi juridiksionin dhe situatën reale në teren.<sup>[8]</sup> Po ashtu, më 28 dhjetor 2025, në Facebook dhe platforma të tjera sociale u shpërnda një video e gjeneruar me inteligjencë artificiale që pretendonte hapjen e urës kryesore të Ibrit, duke e prezantuar si një ngjarje të momentit, edhe pse verifikimi tregoi se

përmbajtja ishte e manipuluar.<sup>[9]</sup> Këto keqinformata shpesh u publikuan në llogari dhe faqe, duke u përhapur kryesisht përmes rrjeteve sociale si Facebook dhe TikTok.

Përveç materialeve të manipuluar, gjatë periudhës së zgjedhjeve parlamentare dhe lokale janë përhapur edhe pretendime të pabazuara për koalicione dhe blerje votash, duke përfshirë edhe narrativa me përmbajtje ndër-etnike. Më 31 dhjetor 2025, disa publikuan artikuj që pretendonin se Lëvizja Vetëvendosje (LVV) kishte bërë koalicion me Listën Serbe në Graçanicë, edhe pse ligji për vetëqeverisjen lokale parashikon emërimin e nënkryetarit për komunitete dhe VV kishte garuar në një koalicion shqiptar në zgjedhje.<sup>[10]</sup> Një tjetër mashtrim i shpërndarë në Facebook pretendonte se Policia e Kosovës kishte ndaluar një furgon me mbi 2 milionë euro dhe 1 milion dinarë serb, të dyshuara për blerje votash nga

[7] [Video me pretendimin për të rinjtë serbë, e gjeneruar më inteligjencë artificiale | hibrid.info](#)



[8] [Përdoret gabimisht termi “komunat serbe” për komunat në veri të Kosovës | hibrid.info](#)

[9] [Video e gjeneruar me inteligjencë artificiale | hibrid.info](#)

[10] [Pretendim i pasaktë për koalicion mes LVV-së dhe Listës Serbe në Graçanicë | hibrid.info](#)

Serbia; ky pretendim nuk u konfirmua nga Policia e Kosovës apo media kredibile.<sup>[11]</sup> Të gjitha këto tema tregojnë një tendencë të qëllimshme për përdorim të keqinformatave për

manipulimin e perceptimeve ndër-etnike dhe ndikimin e opinionit publik, duke përdorur shpesh rrjetet sociale si mjet kryesor të përhapjes së informacionit të rremë.



### Keqinformimi në serbisht

Gjatë periudhës tetor–dhjetor 2025, mediat në gjuhën serbe përhapën një sërë keqinformatesh dhe narrativa të qëllimshme lidhur me raportet ndër-etnike dhe situatën në veri të Kosovës, shpesh duke përfshirë edhe çështje politike dhe zgjedhore. Më 14 tetor 2025, portali serb Pozitivnasrpska.com publikoi një pretendim të pabazë se

Kosova kishte bërë një “ultimatum” ndaj Serbisë për lëshime territoriale, përfshirë rajonin e Rashkës, pa ofruar asnjë burim zyrtar apo dokument që ta mbështeste këtë informacion.<sup>[12]</sup>

Më 23 dhjetor 2025, kanalet në Telegram si “Српски Инат” dhe “КОРИДОР” publikuan pretendime të

[11] Pretendohet rrejtshëm se u ndalua një furgon me para nga Serbia për blerje votash në Kosovë | [hibrid.info](http://hibrid.info)

[12] Pretendim i pabazë se Kosova ka bërë kërkesë territoriale ndaj Serbisë | [hibrid.info](http://hibrid.info)


pabazuara se inspektorët shqiptarë po i vizitonin barnatoret serbe dhe u kishte dhënë një afat për mbylljen e tyre, një informacion krejtësisht i rremë dhe pa burime zyrtare.<sup>[13]</sup>

Në mënyrë të ngjashme, më 16 tetor 2025, portali serb Pravda.rs publikoi një artikull që lidhte pa bazë emrin e kryeministrit Albin Kurti me një tentim-grabitje të një vajze serbe, duke krijuar një perceptim të gabuar te audienca serbe, pasi në fakt të dyshuarit ishin liruar dhe nuk kishte asnjë lidhje me Kurtin.<sup>[14]</sup>

Po ashtu, më 17 tetor 2025, Lista Serbe dhe Zyra për Kosovën në Qeverinë e Serbisë publikuan pretendime në mediat

serbe dhe në portalin Blic.rs, sipas të cilave hyrja e një konvoji të Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK) në Mitrovicë të Veriut ishte e qëllimshme dhe lidhej me zgjedhjet, duke përfshirë edhe emrin e kryeministrit Albin Kurti. Ky pretendim ishte i rremë, pasi FSK dhe Policia e Kosovës sqaruan se bëhej fjalë për një ngatërrim rrugësh, ndërsa KFOR-i konfirmoi se nuk kishte ndonjë kërcënim të qëllimshëm.<sup>[15]</sup>

Këto tema tregojnë se përmes kanaleve serbe, përfshirë Telegram-in dhe portale me reputacion të diskutueshëm, përhapet informacion i manipuluar dhe teori konspirative, duke tentuar të krijojë frikë dhe tension ndër-etnik në veri të Kosovës.



[13] Pretendohet pa fakte se inspektorët shqiptarë u kanë dhënë afat barnatoreve serbe për mbyllje | [hybrid.info](https://www.hybrid.info)

[14] Ndërlidhje pa bazë e emrit të Kurtit me një ngjarje në veri | [hybrid.info](https://www.hybrid.info)

[15] Ndërlidhet pa fakte hyrja e gabuar e FSK-së në veri me zgjedhjet në Kosovë | [hybrid.info](https://www.hybrid.info)

# Ndikimi dhe manipulimi i informacionit nga jashtë (FIMI)

Gjatë periudhës së monitoruar, u përhapën një sërë keqinformatesh dhe pretendimesh të pabazuara që synonin të manipulojnë perceptimin e publikut mbi shqiptarët dhe situatën ndër-etnike në Kosovë. Këto përfshijnë akuzime për dhunë, incidente të trilluar dhe teori konspirative, të përhapura kryesisht përmes mediave serbe, kanaleve sociale si Telegram, dhe disa mediave në gjuhë të tjera, duke krijuar një ambient të tensionuar dhe të pasigurt për publikun.

## Pretendime të pabazuara dhe dezinformata për shqiptarët

Gjatë periudhës së monitoruar, disa pretendime të qarta dezinformuese u përhapën lidhur me veprime të pretenduara kriminale të shqiptarëve. Një shembull është rasti i njohur si “Panda” në Pejë, ku kanalet serbe në Telegram pretenduan se më 14 dhjetor 1998 gjashtë të rinj serbë u vranë nga “terroristët shqiptarë”, pa asnjë provë apo konfirmim nga institucionet zyrtare, duke u bazuar vetëm në narrativa spekulative. Një tjetër pretendim i pabazuar ishte se shqiptarët kishin shkatërruar dy gurë varresh në varrezat ortodokse në Plemetin pranë Obiliqit, një deklaratë e

përhapur përmes mediave sociale më 13 dhjetor 2025. Po ashtu, disa media ruse raportuan pa prova se ish-udhëheqësit e UÇK-së, që po gjykohen në Dhomat e Specializuara të Kosovës në Hagë, kishin vranë serbë, ndërsa mediat serbe lidhën një shqiptar të njohur si “Kasapi” me veprime të pretenduara të procesit të heqjes së organeve në “shtëpinë e verdhë” në Burrel. Të gjitha këto tema përbëjnë shembuj të qartë të keqinformimit të qëllimshëm dhe të përdorimit të narrativave të pabazuara për të krijuar perceptime negative për shqiptarët.

## Narrativa ndër-etnike dhe teori konspirative

Përveç dezinformatave direkte, një pjesë e konsiderueshme e përmbajtjeve të përhapura lidhej me teori konspirative dhe narrative ndër-etnike, që synonin të tensiononin marrëdhëniet mes komuniteteve. Drejtori i Postës së Serbisë, Zoran Angjellković, pretendoi

se kryeministri Albin Kurti po synonte konflikt me Serbinë për t'u bërë “komandant lufte”, një deklaratë pa baza faktike dhe e mohuar nga institucionet e sigurisë në Kosovë dhe Serbia. Në mënyrë të ngjashme, Petar Petković nga Qeveria e Serbisë

konspironte se armatosja e FSK-së nuk kishte qëllime mbrojtëse, por synonte të frikësonte dhe kërcënonte komunitetin serb, duke përfshirë furnizimin me dronë kamikazë “Skydagger” nga Turqia. Mediat serbe gjithashtu raportuan pretendime të pabazuara për të shtëna nga grupet shqiptare pranë bazës “Debela Glava” dhe lidhën mosvotimin e qeverisë në Kosovë me përgatitje për luftë. Në këtë kontekst,

edhe narrativa e “Shqipërisë së Madhe” u përdor për të interpretuar protestat dhe deklaratat pa prova, duke krijuar perceptime të rreme se kishte plane për bashkim të territoreve, ndërsa tensioni ndër-etnik përkeqësohej. Këto shembuj tregojnë qartë se si keqinformimi dhe teoritë konspirative mund të përdoren si mjete për manipulimin e perceptimeve publike dhe për nxitjen e frikës dhe pasigurisë ndër-etnike.

### **Narrativat serbe dhe ruse për zgjedhjet lokale në Kosovë**

Gjatë zgjedhjeve lokale të mbajtura më 12 tetor 2025 në Kosovë, Lista Serbe fitoi nëntë komuna me shumicë serbe pa balotazh, ndërsa në komunën e Kllokotit gara mbeti e hapur përmes raundit të dytë. Pas publikimit të rezultateve, zyrtarët dhe mediat serbe zhvilluan një diskurs të konsoliduar interpretues, duke i paraqitur zgjedhjet si një fitore politike dhe strategjike për komunitetin serb dhe për politikën e Beogradit ndaj Kosovës.

Narrativat serbe gjatë dhe pas procesit zgjedhor ndërton një ndarje të qartë mes protagonistëve dhe antagonistëve. Si protagonistë u paraqitën Lista Serbe, kandidatët dhe kryetarët serbë të zgjedhur, komuniteti serb në Kosovë, si dhe Serbia dhe presidenti Aleksandar Vuçiq, të cilët u portretizuan si garantues të mbijetesës, unitetit dhe të drejtave politike të serbëve. Në anën tjetër, kryeministri Albin Kurti, Qeveria dhe institucionet e Kosovës, si dhe partitë jo-serbe në komunat me shumicë serbe, u paraqitën si aktorë pengues dhe

kërcënues, të lidhur me politika të cilësuar si diskriminuese ndaj komunitetit serb. Në këtë kornizë, zgjedhjet u konceptuan jo si proces demokratik lokal, por si një përballje identitare dhe politike, ku pjesëmarrja në votime u interpretua si shprehje besnikërie ndaj Beogradit dhe si kundërshtim ndaj institucioneve të Prishtinës.

Gjatë fushatës zgjedhore, diskursi politik dhe mediatik serb u fokusua në mobilizimin e komunitetit serb në Kosovë përmes një narrative të intensifikuar, e cila e paraqiste procesin zgjedhor si çështje ekzistenciale dhe kombëtare. Votimi u kornizua si akt lojaliteti ndaj Serbisë dhe presidentit Vuçiq, ndërsa Qeveria e Kosovës dhe kryeministri Kurti u portretizuan si burim kërcënimi për sigurinë dhe ekzistencën e serbëve. Në këtë kontekst, Lista Serbe u prezantua si e vetmja përfaqësuese legjitime e “vullnetit të serbëve”, duke forcuar narrativën e unitetit politik dhe të monopolizimit të përfaqësimit serb.<sup>[16]</sup>

[16] [Narrativat e Serbisë për zgjedhjet lokale në Kosovë: nga mobilizimi etnik te viktimizimi politik | hibrid.info](#)

Pas shpalljes së rezultateve, narrativat u zhvendosën drejt interpretimit të fitores. Rezultatet u paraqitën si garanci për ruajtjen e kontrollit politik të komunitetit serb në komunat me shumicë serbe dhe si kundërshtim ndaj politikave të Qeverisë së Kosovës, të cilat u etiketuan si diskriminuese. Fitorja u interpretua gjithashtu si rezultat i unitetit të serbëve dhe i mbështetjes direkte të Beogradit, ndërsa vota për Listën Serbe u paraqit si një formë

referendumi politik për legjitimitetin e Serbisë në Kosovë. Diskursi paszgjedhor theksoi pjesëmarrjen e lartë të votuesve serbë si dëshmi të fuqisë dhe legjitimitetit politik të Listës Serbe, duke përfshirë edhe narrativa paralajmëruese që portretizonin institucionet e Kosovës si pengesë potenciale për ushtrimin e pushtetit lokal serb.<sup>[17]</sup>

### **Narrativat kryesore serbe për zgjedhjet lokale:**

- **Zgjedhjet si betejë ekzistenciale për komunitetin serb:** *Procesi zgjedhor u kornizua jo si garë demokratike lokale, por si përballje vendimtare për mbijetesën politike, institucionale dhe identitare të serbëve në Kosovë.*
- **Lista Serbe si përfaqësuesja e vetme legjitime:** *Lista Serbe u paraqit si e vetmja forcë politike që përfaqëson “vullnetin autentik” të komunitetit serb, duke përjashtuar alternativat e tjera politike dhe duke ndërtuar narrativën e unitetit të detyruar politik.*
- **Viktimizimi i komunitetit serb dhe delegjitimimi i institucioneve të Kosovës:** *Qeveria e Kosovës dhe kryeministri Albin Kurti u portretizuan si burim presioni, diskriminimi dhe rreziku për sigurinë e serbëve, ndërsa institucionet e Kosovës u paraqitën si jolegjitime ose armiqësore.*
- **Fitorja zgjedhore si konfirmim i rolit të Beogradit:** *Rezultatet zgjedhore u interpretuan si dëshmi e mbështetjes së komunitetit serb për politikën e Serbisë në Kosovë dhe për rolin e Beogradit si mbrojtës dhe garantues i interesave serbe.*

Mbulimi i zgjedhjeve lokale të 12 tetorit 2025 në Kosovë nga platformat mediatike ruse RT Balkan dhe Sputnik Serbia dhe komentet e zyrtarëve të lartë rusë paraqet një fushatë të koordinuar informacioni që synonte të riformësonte perceptimin e procesit

demokratik vendor. Gjatë periudhës nga 13 shtatori deri më 15 tetor 2025, Sputnik Serbia publikoi 43 artikuj, ndërsa RT Balkan 31 artikuj, duke i dhënë jehonë narrativave të ndërtuara nga Beogradi. Artikujt portretizuan Listën Serbe si protagonistin kryesor, ndërsa Albin

[17] [Narrativat serbe pas zgjedhjeve lokale në Kosovë: Fitorja e Listës Serbe dhe mesazhet politike | hibrid.info](#)

Kurti dhe institucionet e Kosovës u paraqitën si faktorë destabilizues dhe burim i “represionit”. Diskursi përfshinte ide të “betejës për mbijetesën” së komunitetit serb, presionin e institucioneve kosovare, rrezikun e ndryshimit etnik dhe nevojën për rikthim të kontrollit mbi komunat me shumicë serbe. Fjalori dhe korniza e përdorur nga këto media u reflektuan më pas edhe në komunikimin diplomatik rus, duke legjitimuar pretendimet e Beogradit dhe duke shfaqur mbështetje për Listën Serbe dhe rolin të Vuçiqit si garant i të drejtave serbe.<sup>[18]</sup>

Në nivel zyrtar, Rusia përfaqësohej nga zëdhënësja e Ministrisë së Punëve të Jashtme, Maria Zakharova, e cila në

një konferencë më 17 tetor 2025 ripërsëriti elementët kryesorë të narrativës: zgjedhjet u zhvilluan nën “presion të madh” dhe me kufizim të akreditimit të mediave serbe; fitorja e Listës Serbe përfaqëson një rikthim të kontrollit mbi zonat veriore të Kosovës; kryeministri Kurti u identifikua si shkaktar i tensioneve dhe faktor destabilizues; dhe mbështetja e komunitetit serb për Listën Serbe lidhej drejtpërdrejt me besimin ndaj presidentit Vuçiq. Këto deklarata zyrtare përforcuan dhe legjitimuan narrativat që kishin qarkulluar më parë përmes mediave ruse, duke i dhënë një dimension diplomatik një procesi zgjedhor lokal.<sup>[19]</sup>

### **Narrativat kryesore ruse për zgjedhjet lokale**

- **Zgjedhjet nën presion dhe censurë:** Lista Serbe mori pjesë në zgjedhje në kushte të vështira dhe me kufizim të akreditimit të mediave.
- **Rikthimi i kontrollit të “uzurpuar”:** Fitorja e Listës Serbe shfaqet si një hap për rifitim e kontrollit mbi komunat veriore.
- **Albin Kurti si faktor destabilizues:** Kryeministri portretizohet si shkaktar i tensioneve dhe provokimeve të mundshme.
- **Legjitimimi i Vuçiqit dhe Beogradit:** Mbështetja për Listën Serbe lidhet me besimin e serbëve të Kosovës ndaj presidentit serb.

[18] [Narrativat e mediave ruse, "Russia Today Balkan" dhe "Sputnik Serbia", lidhur me zgjedhjet lokale në Kosovë | hibrid.info](#)

[9] [Narrativat e Zakharovas për zgjedhjet në Kosovë, në sinkron me ato të mediave ruse | hibrid.info](#)

## **Narrativat serbe dhe ruse për zgjedhjet parlamentare në Kosovë**

Në prag të zgjedhjeve parlamentare të 28 dhjetorit 2025, zyrtarët e lartë serbë, përfshirë Petar Petkoviqin dhe presidentin Aleksandar Vuçiq, ndërtuan një diskurs që e paraqet votimin si moment vendimtar për fatin e komunitetit serb në Kosovë. Në këtë kuadër, zgjedhjet janë përshkruar si një betejë ekzistenciale ku Lista Serbe shfaqet si e vetmja forcë politike që mund të mbrojë interesat e serbëve, ndërsa institucionet e Kosovës portretizohen si burim presioni dhe kërcënimi. Diskursi përfshin elemente të viktimizimit, frikësimit dhe mobilizimit politik, duke e zhvendosur debatin nga konkurrenca elektorale drejt një kuadri identitar dhe mbijetesë kolektive. Petkoviq ka theksuar gjithashtu delegjtimimin e alternativave politike serbe, duke paraqitur subjektet e tjera si projekte të Prishtinës që mund të dëmtojnë interesat e komunitetit serb, dhe ka bërë thirrje që serbët e zhvendosur në Serbi të votojnë si akt obligimi kombëtar.

Presidenti Vuçiq ka ndërtuar një narrativë paralele, duke lidhur pjesëmarrjen në zgjedhje me ruajtjen e unitetit kombëtar dhe interesave shtetërore të Serbisë, duke theksuar se Lista Serbe përfaqëson garancinë për stabilitetin politik dhe mbrojtjen e të drejtave serbe. Në këtë linjë, ai ka kritikuar politikën e kryeministrit Kurti dhe ka përshkruar Listën Serbe si mekanizmin kyç të ruajtjes së ndikimit serb në Kosovë. Diskursi shoqërohet edhe me masa konkrete sociale dhe ekonomike, përfshirë hapjen e vendeve të reja të punës në institucionet serbe në Kosovë dhe thirrje për të votuar nga qytetarët e zhvendosur, duke lidhur mirëqenien sociale me pjesëmarrjen elektorale. Në këtë mënyrë, fushata zgjedhore është paraqitur si një proces ku pjesëmarrja në votim përbën një akt mbrojtjeje kolektive të interesave dhe mbijetesës së komunitetit serb.<sup>[20]</sup>

### **Narrativat kryesore serbe për zgjedhjet parlamentare:**

- *Zgjedhjet si moment vendimtar për mbijetesën politike dhe institucionale të serbëve.*
- *Lista Serbe si e vetmja forcë politike që mbron interesat e komunitetit serb.*
- *Institucionet e Kosovës si burim presioni dhe kërcënimi sistematik.*
- *Thirrja për pjesëmarrje masive dhe lidhja e votës me mbrojtjen e komunitetit dhe unitetin kombëtar.*

[20] [Narrativat e zyrtarëve serbë për zgjedhjet e 28 dhjetorit](#) | [hibrid.info](#)

Mediat ruse në gjuhën serbe duke përfshirë RT Balkan (19 artikuj) dhe Sputnik (22 artikuj), kanë paraqitur zgjedhjet parlamentare të 28 dhjetorit 2025 në Kosovë si një proces me rëndësi ekzistenciale për mbijetesën politike dhe identitare të komunitetit serb. Në këtë narrativë, Lista Serbe portretizohet si e vetmja forcë që mund të garantojë mbrojtjen e serbëve nga presioni i institucioneve të Kosovës dhe nga, siç raportohet, përpjekjet për “spastrim etnik” përmes arrestimeve, masa administrative dhe kontrollit të arsimit dhe shëndetësisë. Sipas këtyre medimeve, Albin Kurti dhe Vetëvendosja përdorin retorikë militarizuese dhe “kërcënime serbe” si pretekst për të zhvendosur vëmendjen nga krizat ekonomike dhe për të manipulua votuesit, ndërsa përdorimi i diasporës – me qindra mijëra votues që vijnë për një fundjavë dhe kthehen në vendet e tyre të punës – shihet si një mjet për të garantuar fitoren e Kurtit në një klimë të pretenduar të legjitimitetit të dobët lokal. Kjo qasje portretizon zgjedhjet jo si një garë demokratike, por si një referendum vendimtar midis unitetit serb dhe politikave të Prishtinës, ku çdo votë kundër Listës Serbe paraqitet si kërcënim për të ardhmen e komunitetit serb.

Në këtë kuadër, narrativa e RT Balkan dhe Sputnik thekson se fitorja e të gjitha 10 mandateve të garantuara për Listën Serbe është jetike për të ruajtur lidhjen institucionale dhe financiare me Beogradin dhe për të realizuar tërësisht Asociacionin e Komunave me Shumicë Serbe (AKS), sipas Marrëveshjes së Brukselit. Sipas medimeve, udhëheqësit e Listës Serbe – si Zllatan Elek, Igor Simiq dhe Dalibor Jevtiq – paraqiten si mbrojtës stoikë të serbëve, ndërsa Beogradi zyrtar dhe ambasadori rus Aleksandar Bocan-Harčenko shfaqen si garantues të legjitimitetit dhe mbrojtjes së komunitetit. Ndërkohë, aktorë të tjerë, si Nenad Rashiq, portretizohen si “shërbëtorë të Prishtinës” që nuk kanë legjitimitet te popullsia serbe, ndërsa Komisioni Qendror i Zgjedhjeve akuzohet për vendime të paligjshme dhe për përjashtimin e vëzhguesve, duke krijuar një ambient të pabarabartë dhe të tensionuar politikisht. Kjo narrativë e përbashkët synon të tregojë se pjesëmarrja në zgjedhje nuk është thjesht akt politik, por një akt kolektiv për mbijetesën e komunitetit dhe për ruajtjen e identitetit kombëtar serb në Kosovë.<sup>[21]</sup>

[21] [Narrativat e RT Balkan dhe Sputnik: Si u portretizuan zgjedhjet në Kosovë | hibrid.info](#)

### **Narrativat kryesore ruse lidhur me zgjedhjet parlamentare:**

- **Zgjedhjet si moment vendimtar për mbijetesë:** Zgjedhjet parlamentare paraqiten si ekzistenciale për mbijetesën politike, institucionale dhe identitare të serbëve në Kosovë, ku çdo votë kundër Listës Serbe portretizohet si kërcënim për ekzistencën e komunitetit.
- **Lista Serbe si forca e vetme legjitime:** Lista Serbe përshkruhet si i vetmi aktor politik legjitim dhe si një “linjë shpëtimi” drejt Beogradit, duke garantuar vazhdimin e ndihmës financiare dhe investimeve në shëndetësi, arsim dhe infrastrukturë.
- **Albin Kurti, LVV dhe Nenad Rašić si antagonistë:** Këta aktorë paraqiten si përpjekës për të dobësuar unitetin mes serbëve të Kosovës përmes arrestimeve, manipulimit të votës dhe masave administrative.
- **Diaspora, retorika e militarizuar dhe masat administrative:** Mobilizimi i diasporës, i kombinuar me gjuhë të militarizuar dhe masa të pretenduara administrative kundër Listës Serbe, paraqitet si mekanizëm për të ndikuar në zgjedhje, duke i shndërruar ato praktikisht në një referendum për mbijetesën e komunitetit serb.

# Përfundim

Monitorimi i hapësirës informative gjatë periudhës 9 tetor – 31 dhjetor 2025 tregon se proceset zgjedhore në Kosovë janë shoqëruar nga një prani e konsiderueshme e keqinformimit në mjedisin digjital. Përmbajtjet problematike janë shpërndarë kryesisht përmes mediave sociale, por edhe nga media dhe burime të jashtme, duke u fokusuar kryesisht në zgjedhjet parlamentare dhe lokale. Lajmet e rreme, sondazhet e fabrikuara, deklaratat e paverifikuara dhe materialet e manipuluar vizualisht kanë qenë format më të shpeshta të keqinformimit, me potencial për të ndikuar në perceptimin publik dhe në besimin ndaj procesit zgjedhor.

Analiza krahasuese tregon dallime në strukturën e keqinformimit sipas gjuhëve. Në përmbajtjet në gjuhën shqipe dominon një shumëllojshmëri kategorish, përfshirë lajme të rreme, mashtrime, clickbait dhe manipulim faktesh, ndërsa në përmbajtjet në gjuhën serbe vërehet një përqendrim më i madh në teori konspirative dhe narrativa me karakter ndëretnik dhe të sigurisë. Në të dyja temat, temat që lidhen me zgjedhjet, veriun e Kosovës, komunitetin serb dhe armatosjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës janë përdorur në mënyrë të përsëritur, duke ndikuar në polarizimin e diskursit publik.

Raporti evidenton gjithashtu rritjen e përdorimit të përmbajtjeve të gjeneruara me inteligjencë artificiale gjatë periudhës zgjedhore. Imazhet dhe videot e krijuara ose të manipuluar me AI janë përdorur për të paraqitur në mënyrë të rreme mbështetje politike, deklaratat ose ngjarje, duke e bërë më të vështirë dallimin mes informacionit të saktë dhe atij të manipuluar. Ky zhvillim nënvizon nevojën për mekanizma më të qartë identifikimi, etiketimi dhe verifikimi të përmbajtjeve digjitale, si dhe për rritjen e vetëdijes publike mbi këto forma të reja të keqinformimit.

Në përfundim, gjetjet e këtij raporti tregojnë se keqinformimi gjatë cikleve zgjedhore në Kosovë paraqet një fenomen të vazhdueshëm, i cili ndërthur aktorë vendorë dhe narrativa me ndikim të jashtëm. The findings indicate that, beyond isolated instances of misinformation, there is a consistent pattern of strategic information manipulation that aligns with foreign information manipulation and interference (FIMI) practices and poses tangible risks of destabilisation. Këto praktika ndikojnë drejtpërdrejt në perceptimin e proceseve zgjedhore, në marrëdhëniet ndëretnike dhe në besimin e publikut ndaj institucioneve.

**Për adresimin e këtyre rreziqeve, raporti rekomandon:**

- *Integrimi i vlerësimit të rrezikut nga FIMI në mekanizmat e monitorimit zgjedhor.*
- *Forcimi i bashkëpunimit ndërmjet organizatave vendore të fact-checking-ut, aktorëve të shoqërisë civile dhe mekanizmave të BE-së për të kundërshtuar manipulimin dhe ndërhyrjen e huaj informative.*
- *Monitorimi i vazhdueshëm i platformave të mediave sociale, portaleve të lajmeve dhe burimeve të jashtme të informacionit.*
- *Intensifikimi i përpjekjeve për verifikimin e fakteve dhe rritja e përgjegjësisë redaktuese brenda organizatave mediale.*
- *Bashkëpunimi me platformat digjitale për të identifikuar dhe adresuar përmbajtje problematike, përfshirë materiale të manipuluar dhe përmbajtje të gjeneruara nga inteligjenca artificiale.*
- *Rritja e ndërgjegjësimit publik dhe qëndrueshmërisë mediale ndaj narrativave destabilizuese dhe ndërhyrjeve të huaja.*

Këto masa synojnë forcimin e integritetit të procesit demokratik dhe mbrojtjen e hapësirës informative.

HIBRID.INFO